

# Sondazh: Promovimi i gjyqtarëve dhe sistemi i pikëzimit

---

*Korrupsioni, pavarësia dhe integriteti në sistemin  
e drejtësisë*

---



**Ambasada Britanike**



2012



## **Sondazh: Promovimi i gjyqtarëve dhe sistemi i pikëzimit**



Anketimi është kryer nga Qendra për Transparencë dhe Informim të Lirë (QTIL)<sup>\*1</sup> dhe Ambasada Britanike në vijim të një projekti britanik në bashkëpunim me institucionet shqiptare mbi reformat në sistemin e drejtësisë e vëcanërisht ato në KLD. Anketimi u realizua në periudhën shkurt-mars të këtij viti. U përfshinë në anketim 60% e gjykatave të shkallës së parë në të gjithë vendin. Gjykatësit vijnë nga mbi 50 për qind e gjykatave ose ndryshe nga 14 gjykata prej 23 që janë gjithsej.

Në anketim morën pjesë 58 për qind e gjyqtarëve ose 177 të tillë prej 305 që janë gjithsej në gjykatata e shkallës së parë ose 47 për qind nga 380 gjyqtarë që janë gjithsej në të dy shkallët e gjyqësorit.

Përzgjedhja përfshin gjykata nga të gjitha zonat dhe kategoritë e qyteteve, pra prej gjykatave të vogla dhe në periferi prej vetëm 4 gjykatësish deri tek ato në qendër si gjykata e Tiranës me rreth 67 gjykatës.

### **Objektivi i anketimit është:**

- a. matja e impaktit të reformës në promovimin e gjyqtarëve ndërmarrë nga KLD përgjatë vitit 2011,
- b. matja e perceptimit të gjyqësorit për vetë gjyqësorin dhe
- c. matja e perceptimit të gjyqësorit për pushtetet dhe institucionet e tjera.

### **Qëllimi i anketimit është:**

- a. orientimi i reformës në gjyqësor në pajtim me nevojat e sistemit,
- b. forcimi i besimit të qytetarëve dhe institucioneve të sistemi gjyqësor dhe gjyqtarët
- c. pjesëmarrja e gjyqtarëve në debatin publik për reformin e sistemit gjyqësor dhe institucioneve të tjera

### **Metodologjia:**

-sondazhi zhvillohet me 60% të gjykatësve në shkallën e parë të gjyqësorit, ose së paku 50% e numrit të të gjithë gjyqtarëve që ka vendi.

---

<sup>1</sup> QTIL është organizatë e shoqërisë civile me zyrë në Tiranë, themeluar në vitin 2003, e specializuar në çështjet e monitorimit, transparencës dhe qeverisjes së mirë. QTIL shërben si reporter lokal për Global Integrity, organizatë ndërkombëtare me qendër në Uashington DC, SHBA dhe është anëtare e rrjetit ndërkombëtar të PWYP (Publish What You Pay), me qendër në Londër, Britani.



## Sondazh: Promovimi i gjyqtarëve dhe sistemi i pikëzimit



-sondazhi plotësohet nga vetë gjyqtari, anketuesi ka ndërhyrë vetëm me kërkesën e gjyqtarit gjatë plotësimit të formularit për sqarime të nevojshme rreth pyetjeve


-gjyqtarët mund ta identifikonin veten në sondazh vetëm nëse dëshironin por edhe këtë identifikim vetëm nëpërmjet numrit të telefonit.

-gjyqtarët që kanë dashur kanë pasur mundësi të ruajnë një kopje të formularit të plotësuar

-po ashtu gjyqtarët kanë patur mundësi të bëjnë komente rreth përgjigjes së tyre të cilat natyrisht nuk janë përfshirë në analizën e përgjigjeve të standartazurara por janë patur parasysh në rekomandimet e këtij anketimi.

### Përzgjedhja:

Rreth 35 për qind e gjykatësve të anketuar trajtojnë çështje penale, ndërsa 45 për qind zhvillojnë çështje civile 45. Pjesa tjetër, rreth 19 për qind të të anketuarve nuk e gjejnë veten të ndarë mes dy gjykimeve.



	Frequenc	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid Tjeter	34	19.2	19.2	19.2
Ne civile	80	45.2	45.2	64.4
Ne penale	63	35.6	35.6	100.0
Total	177	100.0	100.0	




## Sondazh: Promovimi i gjyqtarëve dhe sistemi i pikëzimit



### Mosha:


Gjykatësit në përgjithsi janë në moshë të re apo mesatare. 24 për qind e tyre janë në grupmoshën 41-45 vjet, 20 për qind janë në moshën 31-35 vjet, 18 për qind janë në moshën 36-40 vjet, mbi 50 vjet janë 16 për qind, ndërkohë nën 30 vjet janë 8 për qind.



	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid < 30 vjet	11	6.2	7.9	7.9
Valid 31-35 vjet	28	15.8	20.0	27.9
Valid 36-40 vjet	26	14.7	18.6	46.4
Valid 41-45 vjet	34	19.2	24.3	70.7
Valid 46-50 vjet	17	9.6	12.1	82.9
Valid 51-55 vjet	17	9.6	12.1	95.0
Valid 56-60 vjet	6	3.4	4.3	99.3
Valid > 60 vjet	1	.6	.7	100.0
Valid Total	140	79.1	100.0	
Missing System	37	20.9		
Missing Total	177	100.0		

### Gjinia

Rreth 60 për qind e gjykatësve janë meshkuj ndërsa 40 qind janë femra.




	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid Female	61	34.5	39.9	39.9
Valid Male	92	52.0	60.1	100.0
Valid Total	153	86.4	100.0	
Missing 1	24	13.6		
Missing Total	177	100.0		




## Edukimi

Rreth 64 për qind e gjykatësve vijnë direkt nga fakulteti i Drejtësisë ndërsa pjesë tjetër vijnë nga Magjistratura.



	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid Magjistrature	64	36.2	36.2	36.2
Fakulteti i drejtësisë	113	63.8	63.8	100.0
Total	177	100.0	100.0	

Kryqëzimi i të dhënave të punësimit me shkollimin na furnizon me të dhëna të reja rreth ndarjes së „tregut „ të punës mes atyre që kanë përfunduar vetëm fakultetin e Drejtësisë dhe atyre që kanë kryer ndërkaq edhe Magjistraturën.




	Punesimi ne gjykate			Total
	Tjeter	Ne civile	Ne penale	
Edukim Magjistrature	21	26	17	64
i Fakulteti i drejtësisë	13	54	46	113
Total	34	80	63	177



## Sondazh: Promovimi i gjyqtarëve dhe sistemi i pikëzimit




Po ashtu kryqëzimi mes moshës dhe shkollimit na furnizon me të dhëna të tjera. Shumica e gjykatësve me Magjistraturë natyrisht që i përkasin moshave të reja. Numri më i madh i gjyqtarëve me magjistraturë përfshin moshën 31-35 vjet, rreth 6 % të numrit të të gjithë gjyqtarëve.



	Edukimi		Total	
	Magjistratura	Fakulteti i drejtësisë		
Grup Moshë	< 30 vjet	9	2	11
	31-35 vjet	18	10	28
	36-40 vjet	7	19	26
	41-45 vjet	8	26	34
	46-50 vjet	3	14	17
	51-55 vjet	1	16	17
	56-60 vjet	0	6	6
	> 60 vjet	1	0	1
<b>Total</b>		<b>47</b>	<b>93</b>	<b>140</b>

### Përvojat e punësimit:

Gjykatësit e anketuar kanë pasur përvoja të ndryshme punësimi më parë si në administratën civile, avokati, prokurori etj. Konkretisht rreth 72 për qind e tyre kanë përvoja që kanë lidhje me punën e gjyqtarit, pra brenda sistemit, ndërsa vetëm 28 për qind e tyre kanë ardhur prej fushave të tjera të punësimit.




	Responses	Percent of Cases		
		N	Percent	
Punesimi i meparshem(a)	Keni punuar më parë/në administratën civ	45	35.7%	43.3%
	Keni punuar më parë/avokati	29	23.0%	27.9%
	Keni punuar më parë/prokurori	17	13.5%	16.3%
	Keni punuar më parë/te tjera	35	27.8%	33.7%
<b>Total</b>		<b>126</b>	<b>100.0%</b>	<b>121.2%</b>



## Rastet e promovimit


Pyetjes nëse kanë pasur një histori promovimi përgjatë karrierës së tyre në gjyqësor i janë përgjigjur pozitivisht 38 për qind ndërsa afro 62 për qind nuk kanë pasur raste promovimi.



		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo	99	55.9	61.9	61.9
	Po	61	34.5	38.1	100.0
	Total	160	90.4	100.0	
Missing	1	17	9.6		
Total		177	100.0		

## Njohja me kuadrin ligjor apo nenligjor te promovimit:

Në pyetjen që lidhej me njohjen ose jo te kuadrit ligjor e nënligjor të promovimit të gjyqtarëve, të anketuarit janë përgjigjur se nuk e njihnin kuadrin ligjor në masën 2.5 për qind ndërsa kanë qëndruar neutral ndaj kësaj pyetjeje 8.5 për qind, çfarë mund të mendohet se ky numër anketuesish nuk e njeh kuadrin ligjor të promovimit; Janë përgjigjur se e njohin atë afro 90 për qind e të pyeturve.




		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo	4	2.3	2.5	2.5
	Po	158	89.3	97.5	100.0
	Total	162	91.5	100.0	
Missing	1	15	8.5		
Total		177	100.0		



### Njohja me procedurat e sistemit të pikëzimit:

Rreth 24 për qind e gjyqtarëve nuk i kanë të qarta procedurat e parashikuara të ndiqen për ndërtimin e sistemit të pikëzimit ndërsa 64 për qind i kanë të qarta ato. Edhe në këtë rast mund të përfshijmë tek të paqartët edhe ata që kanë qëndruar neutral në këtë pyetje tërësisht teknike.




		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo	43	24.3	27.4	27.4
	Po	114	64.4	72.6	100.0
	Total	157	88.7	100.0	
Missing	1	20	11.3		
Total		177	100.0		

### Gjykatat e karrierës:

Gjyqtarët janë pyetur nëse janë dakord me konceptin e gjykatave të karrierës (pra se mund të quhet promovim edhe transferimi i gjyqtarëve nga një rreth i kategorisë së dytë në të parën, nga periferia në qendër?)

Përgjigjet e tyre kanë qënë në favor të kësaj pyetjeje ose kanë qëndruar neutral ndaj saj në masën 77 për qind ndërsa janë shprehur kundër 23 për qind.



		Frequency	Percent	Valid Percent
Valid	Jo	40	23	23
	Po ose neutral	137	77	77
Total		177	100.0	100.0






**Sondazh:**  
**Promovimi i gjyqtarëve dhe sistemi i pikëzimit**



**Vlerësimi për ndarjen e pikëve:**

*Pikët maksimale që mund të arrihen nga sistemi i pikësimit janë 200 prej të cilave 100 pikë i atribuohen vjetërsisë në profesion, 80 rezultateve të punës në vijimësi dhe 20 pikë veprimtarisë shkencore dhe akademike.*


Gjyqtarët e aprovojnë ndarjen e pikëve për ndërtimin e sistemit të pikëzimit në masën 46 për qind ndërsa nuk janë dakord me të në afro 41 për qind të të pyeturve.



		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo	73	41.2	47.1	47.1
	Po	82	46.3	52.9	100.0
	Total	155	87.6	100.0	
Missing	1	22	12.4		
Total		177	100.0		

**Vlerësimi për praktikën e mëhershme të promovimit:**

Gjyqtarët janë të ndarë fort në lidhje me vlerësimin që ata japin për praktikën e mëparshme të promovimit. Rreth 47 për qind i konsiderojnë të padrejta, 16 për qind të korruptuara, 22 për qind konkurente dhe 14 për qind të drejta.



		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	konkurente te drejta	34	19.2	22.2	22.2
	te korruptuara te padrejta	24	13.6	15.7	52.3
	te drejta	73	41.2	47.7	100.0
	Total	153	86.4	100.0	
Missing	1	24	13.6		
Total		177	100.0		




**Sondazh:**  
**Promovimi i gjyqtarëve dhe sistemi i pikëzimit**




**Vlerësimi për sistemin aktual të promovimit:**

Edhe sistemi aktual është i kritikuar nga një numër i konsiderueshëm i gjyqtarëve megjithëse është më i kuotuar në vlerësim se ai i mëparshmi. Të paktën 40 për qind e të anketuarve e konsiderojnë atë të padrejtë apo të korruptuar ndërsa 60 për qind si të drejtë dhe të pakorruptuar.



		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	i drejtë	33	18.6	21.2	21.2
	i korruptuar	22	12.4	14.1	35.3
	i padrejtë	51	28.8	32.7	67.9
	konkurent	50	28.2	32.1	100.0
	Total	156	88.1	100.0	
Missing	1	21	11.9		
Total		177	100.0		

Nga kryqëzimi i dy vlerësimeve të mësipërme përfitohen të dhënat si më poshtë:




		Si e konsideroni sistemin aktual të promovimit të gjyqtarëve				Total
		i drejtë	i korruptuar	i padrejtë	konkurent	
Si i konsideroni praktikën e mëparshme të promovimit të gjyqtarëve	konkurente	6	0	1	27	34
	te drejta	14	1	2	3	20
	te korruptuara	1	13	6	3	23
	te padrejta	10	8	39	16	73
Total		31	22	48	49	150



## Korrupsioni në sistemin gjyqësor

Të anketuarit kanë dhënë mendimin e tyre rreth gjyqësorit në Shqipëri duke ndarë përgjigjen mes alternativave nëse gjyqësori është i korruptuar; nëse nuk është i korruptuar; korrupsioni është vetëm perceptim dhe qëndrimin neutral ndaj pyetjes. Rreth 25 përqind e të anketuarve deklarojnë se gjyqësori në Shqipëri është i korruptuar ose qëndrojnë neutral ndërsa 58 thonë se ai është vetëm perceptim ndërsa vetëm rreth 18 përqind deklarojnë se gjyqësori nuk është i korruptuar.




**Sistemi gjyqësor në Shqipëri**

		Frekuenca	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Është i korruptuar	19	10.7	12.5	12.5
	Korrupsioni është vetëm perceptim	102	57.6	67.1	79.6
	Nuk është i korruptuar	31	17.5	20.4	100.0
	Total	152	85.9	100.0	
Missin g	1	25	14.1		
Total		177	100.0		

## Pavarësia e sistemit gjyqësor

Lidhur me pavarësinë e sistemit gjyqësor, të anketuarit janë shprehur se ai është pjesërisht i pavarur nga politika në masën 50 për qind, është i varur nga politika në 7 për qind ndërsa është i pavarur prej saj në masën 33 për qind. Rreth 10 për qind e tyre nuk janë shprehur lidhur me raportin e gjyqësorit me politikën.




**Sistemi gjyqësor - Pavarësia**

		Frekuenca	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Është i pavarur nga politika	58	32.8	36.3	36.3
	Është i varur nga politika	13	7.3	8.1	44.4
	Është pjesërisht i pavarur nga politika	89	50.3	55.6	100.0
	Total	160	90.4	100.0	
Missin g	1	17	9.6		
Total		177	100.0		



### **Integriteti i sistemit gjyqësor:**

Gjyqtarët kanë dhënë vlerësimin e tyre edhe në lidhje me integritetin e sistemit ku ata punojnë. Rreth 53 për qind thonë se gjyqësori ka pjesërisht integritet, vetëm 2 për qind thonë se ai nuk ka fare, ndërsa 36 për qind thonë se gjyqësori është me integritet në ushtrimin e funksioneve të tij.




Sistemi gjyqësor - Pavarësia

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid				
Është i pavarur nga politika	58	32.8	36.3	36.3
Është i varur nga politika	13	7.3	8.1	44.4
Është pjesërisht i pavarur nga politika	89	50.3	55.6	100.0
Total	160	90.4	100.0	
Missin g	1	0.6		
Total	177	100.0		

### **Kërkesa për favorizim në procesin gjyqësor:**

Pagesa në këmbim të favorizimit në procesin gjyqësor për gjyqtarët është si vijon sipas anketimit: rreth 60 për qind e tyre deklaruan se nuk kanë pasur oferta për tu paguar në këmbim të ndryshimit të vendimit të gjyqit si favorizim për një palë ndërsa mbi 30 për qind kanë pasur oferta të tilla. Rreth 10 për qind kanë hezituuar të përgjigjen në këtë pyetje.




	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid				
Jo	105	59.3	66.0	66.0
Po	54	30.5	34.0	100.0
Total	159	89.8	100.0	
Missin g	1	0.6		
Total	177	100.0		



**Sondazh:**  
**Pavarësia dhe korrupsioni në sistemin e drejtësisë**




Ndërsa kryqëzimi mes atyre që kanë deklaruar se sistemi gjyqësor është i korruptuar ose jo dhe atyre që shprehen rreth ofertave për pagesë në këmbim të favorizimit në një proces gjyqësor është si më poshte:



**Incidenca:**


Përgjatë anketimit është matur edhe incidenca: Nga ata që kanë deklaruar se kanë pasur oferta të tilla 21 për qind e kanë pasur disa herë, 5 për qind vetëm një herë ndërsa rreth 4 për qind shumë shpesh. Pjesa më e madhe e të anketuarve nuk janë përgjigjur në asnjë prej mundësive të ofruara nga pyetja.



		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	disa herë	37	20.9	71.2	71.2
	një herë	8	4.5	15.4	86.5
	shumë shpesh	7	4.0	13.5	100.0
	Total	52	29.4	100.0	
Missing	1	125	70.6		
Total		177	100.0		




Kryqëzimi i incidencës me korrupsionin në sistemin gjyqësor jep një pamje si më poshtë:



		Sa herë je ndodhur përpara një oferte të tillë			Total
		disa herë	një herë	shumë shpesh	
Sistemi gjyqësor në Shqipëri	Është i korruptuar	8	3	1	12
	Korrupsioni është vetëm perceptim	22	2	5	29
	Nuk është i korruptuar	4	3	1	8
Total		34	8	7	49

### Ndërhyrjet prej të tjerëve për favorizim në proces:

Pyetjes se nga kanë ardhur ndërhyrjet për favorizime në procesin gjyqësor, vetë gjyqtarët janë përgjigjur si më poshtë: 5 për qind e tyre kanë thënë se kanë pasur ndërhyrje nga zyrtarët e qeverisë, afro 5 për qind nga anëtarë të Parlamentit, 4 për qind nga zyrtarë të presidencës, 31 për qind nga avokatët, 16 për qind nga zyrtarë të pushtetit lokal dhe 40 për qind nga individë të tjerë.




		Responses		Percent of Cases
		N	Percent	
Nderhyrje(a)	zyrtarë të qeverisë	9	5.0%	8.7%
	të parlamentit	8	4.4%	7.7%
	presidenca	7	3.9%	6.7%
	avokatët	55	30.6%	52.9%
	zyrtarë të pushtetit lokal	28	15.6%	26.9%
	individe	73	40.6%	70.2%
Total		180	100.0%	173.1%



### Pse dështojnë ose shtyhen proceset gjyqësore:

Lidhur me dështimin e proceseve gjyqësore ose vonesën e tyre gjyqtarët renditin arsyet e mëposhtme: Më kryesorja është mungesa apo ndërhyrjet e avokatëve në masën 28 për qind, më pas mungesa e dëshmitarëve e cila pengon një zhvillim normal të procesit në masën 23 për qind, nga mungesat në ligj në masën 20 për qind. Por gjyqtarët renditin edhe arsye të tjera si mungesa e infrastrukturës në masën 10 për qind, mungesa në profesionalizmin e prokurorëve në 8 për qind dhe të gjyqtarëve në masën 3 për qind. Tetë përqind kanë zgjedhur arsye të tjera përveç këtyre që ishin përfshirë në pyetje.




Fajto r(a)	Responses		Percent of Cases
	N	Percent	
ndërhyrjet në procesin gjyqësor	12	2.9%	7.5%
Avokatet	117	28.0%	73.1%
mungesat në ligj	82	19.6%	51.3%
mungesë profesionalizmi i gjyqtarëve	12	2.9%	7.5%
mungesë profesionalizmi te prokurorëve	24	5.7%	15.0%
mungesë infrastrukture	40	9.6%	25.0%
mungesa e dëshmitarëve	96	23.0%	60.0%
Tjetër	35	8.4%	21.9%
<b>Total</b>	<b>418</b>	<b>100.0%</b>	<b>261.3%</b>

### Cilësia e gjyqësorit:

Po cili është mendimi I gjykatësve të shkallës së parë për cilësinë e gjyqësorit në shkallën e parë dhe kolegët e tyre në Apel dhe Gjykatën e Lartë.


Lidhur me gjykatën e shkallës së parë gjyqtarët deklarojnë në masën 44 për qind se ajo ka cilësi të lartë të gjykimit dhe po aq mendojnë se ka nivel të majftueshëm të gjykimit, ndërsa vetëm afro 3 për qind thonë se ka nivel të ulët të gjykimit.



Valid	Fajto	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	ka nivel të lartë të gjykimit	78	44.1	48.4	48.4
	ka nivel të ulët të gjykimit	6	3.4	3.7	52.2
	ka një nivel të majftueshëm të gjykimit	77	43.5	47.8	100.0
	<b>Total</b>	<b>161</b>	<b>91.0</b>	<b>100.0</b>	
Missin g		4	16	9.0	
<b>Total</b>		<b>177</b>	<b>100.0</b>		




**Vlerësimi për cilësinë e gjyqësorit në Apel** zbret në shifrat më të ulëta të vlerësimit: 19 për qind deklarojnë se ka nivel të lartë të gjykimit, 58 për qind se ka nivel të mjaftueshëm të gjykimit ndërsa 14 për qind se ka nivel të ulët të gjykimit.



		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	ka nivel të lartë të gjykimit	33	18.6	20.6	20.6
	ka nivel të ulët të gjykimit	24	13.6	15.0	35.6
	ka një nivel të mjaftueshëm të gjykimit	103	58.2	64.4	100.0
	Total	160	90.4	100.0	
Missing		4	17	9.6	
Total		177	100.0		

**Por vlerësimi për gjykimin në Gjykatën e Lartë** është pak më i mirë se ai për gjykatat e Apelit. Rreth 28 për qind e gjykatësve të shkallës së parë mendojnë se kjo gjykatë ka nivel të lartë të gjykimit, 55 për qind mendojnë se ka nivel të mjaftueshëm të gjykimit dhe 7 për qind deklarojnë se ka nivel të ulët të gjykimit.




		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	ka nivel të lartë të gjykimit	50	28.2	31.4	31.4
	ka nivel të ulët të gjykimit	12	6.8	7.5	39.0
	ka një nivel të mjaftueshëm të gjykimit	97	54.8	61.0	100.0
	Total	159	89.8	100.0	
Missing		4	18	10.2	
Total		177	100.0		





### Kushtet e punës, vlerësimi për pagat:


Gjyqtarët e anketuar në përgjithësi janë të pakënaqur me pagën: 72 për qind e të anketuarve thonë se janë të pakënaqur me pagesën, paksa të kënaqur janë vetëm 14 për qind ndërsa të kënaqur 7 për qind.



		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo	127	71.8	77.4	77.4
	Paksa	24	13.6	14.6	92.1
	Po	13	7.3	7.9	100.0
	Total	164	92.7	100.0	
Missing	4	13	7.3		
	Total	177	100.0		

### Siguria në punë:

Edhe numri I gjyqtarëve që konsiderojnë se janë të pasigurtë në vendin e punës është I konsiderueshëm. Rreth 38 për qind thonë se janë të pasigurtë përkundëjt 18 për qind që deklarojnë të kundërtën. Ndërkaq 37 për qind ndihen paksa të sigurt.




		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo	68	38.4	41.2	41.2
	Paksa	65	36.7	39.4	80.6
	Po	32	18.1	19.4	100.0
	Total	165	93.2	100.0	
Missing	4	12	6.8		
	Total	177	100.0		




### Vleresimi per institucionet e drejtësisë:

Në vlerësimin e gjyqtarëve për punën e KLD, 36 për qind mendojnë se ka punuar mirë ndërsa 64 për qind mendojnë se ka punuar keq ose mjaftueshëm ose respektivisht 10 për qind deklarojnë se ka punuar keq dhe rreth 46 për qind mjaftueshëm.



		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Keq	17	9.6	10.6	10.6
	Mire	64	36.2	39.8	50.3
	mjaftueshem	80	45.2	49.7	100.0
	Total	161	91.0	100.0	
Missing	4	16	9.0		
Total		177	100.0		


Për ministrinë e Drejtësisë gjyqtarët kanë vlerësim më të mirë. Në masën 38 për qind deklarojnë se ka punuar mirë, 45 për qind deklarojnë se ka punuar mjaftueshëm dhe vetëm 7 për qind vlerësojnë se ministria e Drejtësisë ka punuar keq.



		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	keq	13	7.3	8.0	8.0
	mire	68	38.4	42.0	50.0
	mjaftueshem	81	45.8	50.0	100.0
	Total	162	91.5	100.0	
Missing	4	15	8.5		
Total		177	100.0		



**Ndërsa për sa i përket Konferencës Gjyqësore gjyqtarët e shkallës së parë kanë dhënë vlerësim negativ në masën 21 për qind, mirë 25 për qind dhe mjaftueshëm 46 për qind.**




		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	keq	37	20.9	22.7	22.7
	mire	44	24.9	27.0	49.7
	mjaftueshem	82	46.3	50.3	100.0
	Total	163	92.1	100.0	
Missing	4	14	7.9		
Total		177	100.0		

### Vlerësimi për korrupsionin në institucione të tjera:

Por ndërkaq gjyqtarët janë edhe pjesë e shoqërisë. Për të matur vlerësimin e tyre për korrupsionin në sektorë të tjerë publikë kemi vlerësuar përgjigjet në dy pyetje:


Për pyetjen se **“A keni paguar kur keni marrë një shërbim mjekësor”**, gjyqtarët përgjigjen **“po”** në masën 24 për qind, nuk kanë paguar 45 për qind e tyre dhe ndonjëherë 20 për qind.



		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	jo	79	44.6	50.3	50.3
	ndonjehere	36	20.3	22.9	73.2
	po	42	23.7	26.8	100.0
	Total	157	88.7	100.0	
Missing	4	20	11.3		
Total		177	100.0		



Ndërsa në pyetjen “**A keni paguar kur keni marrë një shërbim nga administrata publike që jepet pa pagesë**”, gjyqtarët thonë se kanë paguar vazhdimisht në masën tetë përqind, ndonjëherë në 19 për qind dhe nuk kanë paguar asnjëherë në 64 për qind .




		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	jo	113	63.8	70.6	70.6
	ndonjëherë	33	18.6	20.6	91.3
	po	14	7.9	8.8	100.0
	Total	160	90.4	100.0	
Missing	4	17	9.6		
Total		177	100.0		

### Vlerësimi për shoqërinë civile dhe median

Gjyqtarët kanë dhënë mendimin e tyre edhe për rolin e medias dhe shoqërisë civile në rritjen e cilësisë së gjyqësorit në vend.

Vetëm 10 për qind e gjyqtarëve të pyetur mendojnë se shoqëria civile e ka ndihmuar gjyqësorin, 34 për qind mendojnë se e ka ndihmuar pak ndërsa 45 për qind thonë se shoqëria civile nuk ka qënë aspak ndihmë për gjyqësorin.




#### Mendoni se shoqëria civile

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	e ka ndihmuar gjyqësorin	18	10.2	11.4	11.4
	e ka ndihmuar pak gjyqësorin	60	33.9	38.0	49.4
	nuk e ka ndihmuar aspak gjyqësorin	80	45.2	50.6	100.0
	Total	158	89.3	100.0	
Missing	4	19	10.7		
Total		177	100.0		



### Vlerësimi për median:

Ndërsa në rastin e medias gjyqtarët përgjigjen në masën 14 për qind se ajo është mbështetje për ta, në masën 32 për qind se ajo është presion për ta ndërsa 44 për qind e gjyqtarëve thonë se media është thjesht një burim informimi.



Në raport me punën tuaj të përditshme media përbën

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	mbështetje	24	13.6	15.2	15.2
	presion	57	32.2	36.1	51.3
	vetëm informim	77	43.5	48.7	100.0
	Total	158	89.3	100.0	
Missing	4	19	10.7		
Total		177	100.0		

### Përfundime:

-Gjyqtarët e njohin pjesërisht procedurën e sistemit të pikëzimit por njohin mirë kuadrin ligjor që lidhet me nevojën e zbatimit të tij.

-Gjyqtarët kërkojnë ndryshime në formulën e sistemit të pikëzimit. Është I nevojshëm rishikimi I formulës pas një konsultimi të gjerë me një numër sa më të madh gjykatësish ose përfaqësues të tyre si shoqatat e gjyqtarëve.

-Gjyqtarët janë shprehur në mazhorancë për mbajtjen e sistemit të gjykatave të karrierës.

-Të anketuarit thonë në një numër të konsiderueshëm rastesh se kriteri i vjetërsisë në punë do të penalizonte nga promovimi gjyqtarët që kanë mbaruar magistraturën. Duke patur parasysh se ky kriter merr 100 pikë dhe magistratët që punojnë në gjykatë janë në mazhorancë mes moshës 30-40 vjec.



-Gjyqtarët janë kritikë ndaj sistemit të drejtësisë. Ata mendojnë në shifra të konsiderueshme se drejtësia është e korruptuar dhe ka mungesë integriteti.

-Gjyqtarët janë joshur në mënyrë të konsiderueshme për të favorizuar një palë në procesin gjyqësor

-Ndërhyrjet më të mëdha me qëllim ndikimin e vendimit të gjykatës vijnë nga avokatët dhe zyrtarë apo drejtues të pushtetit lokal. Në Tiranë kjo ndërhyrje është më e madhe nga deputetë dhe zyrtarë të lartë. Edhe pse e vogël shifra që paraqet ndërhyrjen e Presidencës është e konsiderueshme dhe mjaft e dëmshme për shkak të konfliktit të interesit dhe prodhimit të një përqindjeje edhe pse të vogël nga një grup mjaft i vogël zyrtarësh.

-Gjyqtarët rendisin si shkaktar kryesorë të dështimit të proceseve apo zgjatjes së tyre mungesën e dëshmitarëve në gjyq dhe mungesën e avokatëve. Po ashtu një vend të konsiderueshëm zënë edhe arsye të lidhura me boshllëqe ligjore.

-Gjyqtarët mendojnë se niveli I gjykimit është më i mirë në shkallën e parë dhe më pas përkeqësohet në shkallën e dytë për të pësuar një ngritje të lehtë në gjykatën e Lartë.

-Ndër institucionet e drejtësisë gjyqtarët kanë zgjedhur si më efektivin ministrinë e drejtësisë për të vazhduar më pas me KLD dhe në fund me Konferencën Gjyqësore.

-Gjyqtarët vetë janë shpesh pre e korrupsionit në shërbimet publike ku ata paguajnë.

-Gjyqtarët vlerësojnë se shoqëria civile nuk i ka ndihmuar aspak.

-Po ashtu ata vlerësojnë se media në jo pak raste përbën presion.

-Anketimi në përgjithësi ia ka dalë të marrë përgjigje të drejta nga gjyqtarët çfarë vertetohet nga kryqëzimi i të dhënave apo krahasimi i përgjigjeve në pyetjet të ndryshme brenda të njëjtit subjekt. Gjyqtarët nuk kanë hezitur fort të flasin për korrupsionin në gjykata.

-Por ka raste të konformizmit të tyre sic janë përgjigjet për vlerësimin e sistemit të kaluar të promovimit dhe atij aktual. Supozohet se gjyqtarët me histori promovimi e kanë vlerësuar pozitivisht sistemin e vjetër të promovimit ndërsa të tjerët negativisht.



## **Propozime**

-Nevojitet një fushatë informimi për gjyqtarët lidhur me sistemin e ri të promovimit dhe vecmas të procedurave. Një kënd i vecantë në faqen e KLD-së, Ministrisë së Drejtësisë dhe Gjykatave si dhe raunde të informimit në gjykatat e ndryshme të vendit do të shërbenin për njohjen më të mirë të sistemit të pikëzimet etj.

-Është i nevojshëm rishikimi i formulës pas një konsultimi të gjerë me një numër sa më të madh gjykatësish ose përfaqësues të tyre si shoqatat e gjyqtarëve.

-Propozimet që vijnë nga gjyqtarët aktualisht kanë të bëjnë kryesisht me:

a. përfshirjen në sistemin e pikëzimit të cilësisë së gjykimit, volumin e punës së gjyqtarit ose sasia e gjykimeve, shpejtësia e gjykimit, lloji i çështjeve të trajtuar nga gjyqtarët, niveli i arsyetimit të vendimit gjyqësor; mungesa e masave disiplinore. por ka edhe propozime të tjera më të rralla por që mund të përfshihen në debat si etika e gjyqtarëve, verifikimi i pasurisë personale, solemniteti në gjykim.

b. rregullimin e raporteve mes pikëve vecmas ato që i përkasin vjetërsisë në punë dhe punës akademike dhe shkencore. Propozimet janë si vijon; të ulet pikëzimi për shkak të vjetërsisë në punë për shkak se penalizon nga promovimi gjyqtarët me magistraturë; veprimtaria shkencore të marrë më pak pikë për shkak se kjo lloj veprimtarie kërkon impenjim dhe rëndon mbi përkushtimin e gjyqtarit në punën e tij të përditshme;

-Vendosja në efikasitet e ndryshimeve mbi ligjin e avokatisë

-Krijimi i një strukture e cila bën të mundur frekuentimin e dëshmitarëve në gjyqe.

-Është e domdososhme të evidentohen rastet ku gjyqtarët mendojnë se ka boshllëqe ligjore për të rishikuar ligje të ndryshme.